
FINANCIAL MANAGEMENT IN ECONOMIC GROWTH OF TRANSITION COUNTRIES: IN KOSOVO WILL BE SPECIAL

Baki KoleciUniversity “Haxhi Zeka” – Peja, Kosovo, baki.koleci@hotmail.com

Abstract: The link between financial management and economic growth is a matter that is constantly being studied and discussed by various authors. The banking industry is an important source of economic development in the country, both in the private and public sectors. The lack of data for a multi-annual period remains a continuing problem for Kosovo's economy. Through multiannual data researchers and scholars will be able to draw the most accurate conclusions for transition countries. Through this study, we will show the empirical link between financial management, the banking system, economic growth in transition countries, and especially data from Kosovo. We will demonstrate through the Regression Model (OLS) and three explanatory variables: Inflation, Credit to Household Economics and Credit Enterprise, we will reach the hypothesis conclusion. The results of regression show a positive and negative correlation between financial management, credit, and economic growth. From the results obtained, lies the hypothesis: where credit to households has a negative impact on economic growth. But the hypothesis is based: where the credit of the enterprise has a positive economic growth, while the offspring turns negative with economic growth. The purpose of this work is to fill this poor gap. New and ongoing research makes data completion, delivering the most accurate results and scope for improving financial policies.

Various banking functions point to their importance for an effective and stable banking system as indispensable for the country's economy. Therefore, bank supervisors have an increased responsibility for monitoring and maintaining the healthy operation of a banking industry in a country.

Moreover, individual entrepreneurs or investors usually lack sufficient capital to continue with their projects. Commercial banks provide mediation services that unite savers and investors by channeling theoretically investment funds for uses that bring the highest rate of return, increasing the specialization and division of labor (Todaro, 2003). The neoclassical growth model tells us that an increase in effective savings investments in new and innovative projects is one of the main economic growth generators (quoted in Armenta).

The provision of credit is of utmost importance because mobilized assets can be rationally utilized, using them in the sphere of production, speeding up the reproduction process, turnover and other sectors, which are accounted for as sectors that accelerate economic development. Loans are very important and one of the main factors in stimulating economic development in the region, so the focus in the first part of this paper will be analysis of the role of loans and their impact on economic growth (credit growth in GDP), where the main interest in this paper will be Kosovo.

Keywords: financial management, banking system, economic growth and transition countries.

**MENAXHIMI FINANCIARË NË RRRITJE EKONOMIKE
TË VENDEVE NË TRANZICION: NË THEKS TË VEÇANTË KOSOVA****Baki Koleci**Universiteti “Haxhi Zeka” – Pejë baki.koleci@hotmail.com

Abstrakt: Lidhja ndërmjet menaxhimit financiar dhe rritjes ekonomike është një çështje e cila studiohet dhe diskutohet në mënyrë të vazhdueshme nga autorët të ndryshëm. Industria bankare është një burimi rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në vend, si në sektorin privat ashtu edhe publik. Mungesa e të dhënave për një periudhë shumëvjeçare mbetet një problem i vazhdueshëm për ekonominë e Kosovës. Përmes të dhënave shumëvjeçare hulumtuesit dhe studiuesit do të mund të nxjerrin konkluzione më të sakta për vendet në tranzicion.

Nëpërmes të ketij punimi, do të tregojmë lidhjen empirike të menaxhimit financiar, sistemit bankar, në rritje ekonomike në vendet në tranzicion, në veçanti të dhenat nga Kosova. Ne do ta demonstrojmë përmes modelit regresionit (OLS) dhe tri variabla shpjeguese, inflacioni, kredit ekonomisë familjare dhe kredit ndërmarrjes, do të arrijmë në konkluzionin e hipotezave.

Rrezultatet e regresionit tregojnë një lidhje pozitive si dhe negative mes menaxhimit financiar, kredit, me rritjen ekonomike. Nga rezultatet e nxerura, hudhet posht hipoteza: ku kredit ekonomisë familjare ka ndikim negativ në rritjen ekonomike. Mirëpo mbështetet hipoteza: ku kredit e ndërmarrjes ka ndikim pozitiv në rritje ekonomike, ndërsa inflacioni rrezullton një lidhje negative me rritjen ekonomike.

Synimi i këtij punimit është plotësimi i këtij hendekut të varfur. Hulumtimet e reja dhe të vazhdueshme e bëjnë kompletimin e të dhënave, duke u mundur të japin rezultate sa më të sakta dhe hapsirë për përmirësimet e politikave financiare.

Funksionet e ndryshme të bankave tregojnë rëndësinë e tyre për një sistem efektiv dhe stabil bankar, si i domosdoshëm për ekonominë e vendit. Prandaj, mbikëqyrësit e bankave kanë një përgjegjësi të shtuar për monitorimin dhe ruajtjen e operimit të shëndoshë të industrisë bankare të një vendi.

Për më tepër, sipërmarrësve individualë apo investitorëve zakonisht iu mungon kapitali i mjaftueshëm për të vazhduar me projektet e tyre. Bankat komerciale ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit, që i bashkojnë kursimtarët dhe investitorët, duke i kanalizuar në mënyrë teorike fondet e investimeve për përdorimet që sjellin normën më të lartë të kthimit, duke e zmadhuar specializimin dhe ndarjen e punës (Todaro, 2003). Modeli neoklasik i rritjes na tregon se një rritje në investimet e efektshme të kursimeve në projekte të reja dhe inovative është një nga gjeneratorët kryesorë të rritjes ekonomike (cituar në Armenta).

Dhënia e kredive është një vlerë më rëndësi, sepse mjetet e mobilizuara mund të shfrytëzohen racionalisht, duke i përdorur në sferën e prodhimit, në shpejtimin e procesit të riprodhimit, të qarkullimit dhe të sektorët e tjerë, të cilët llogariten si sektorë që përshpejtojnë zhvillimin ekonomik. Kreditë janë mjaft të rëndësishme dhe një ndër faktorët kryesorë në stimulimin e zhvillimit ekonomik në rajon, prandaj edhe fokusi në pjesën e parë të këtij punimi do të jetë analiza e rolit të kredive dhe ndikimi i tyre në rritjen ekonomike (Rritja e kredive në GDP), ku interesi kryesor në këtë punim do të jetë Kosova.

Fjalët kyçe: menaxhimi financiar, sistemi bankar, rritja ekonomike dhe shtetet në tranzicion.

HYRJE

Është një fakt i njohur që bankat luajnë disa role në çdo ekonomi. Dhe këto role kanë për qëllim sigurimin e sistemit të shëndoshë financiar dhe stabilitetin ekonomik. Është e padiskutueshme se sistemi bankar është motori i rritjes në çdo ekonomi, duke pasur parasysh funksionin e tij të ndërmjetësimit financiar. Ndërmjet këtij funksioni, bankat në mënyrë të lehtësuar formojnë kapitalin dhe bëjnë promovimin e rritjes ekonomike (Omankhanlen, 2012).

Gjatë epokës socialiste, në të gjithë rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) ekzistonte një sistem monobankë. Me reformën e sektorit bankar pas vitit 1990, këto vende shfuqizuan ish-sistemin monobankë dhe themeluan të ashtuquajturin sistem bankar me dy nivele, i cili është tipik për ekonominë e tregut. U zbatua konsolidimi i bankave komerciale dhe privatizimi nga investitorët e vendit dhe të huaj. Me pjesëmarrjen e bankave të huaja, shërbimet e reja janë futur në një kohë të shkurtër në këto vende dhe, në krahasim me sistemin monobankë të epokës socialiste, praktikata e menaxhimit të riskut të bankave dhe efikasitetit financiar janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme (Banincova, 2012).

Ritmi i shpejtë i zgjerimit të kredive në vendet e EQL-së, në përgjithësi nga një bazë e ulët, është e mundur të jetë nxitur nga një proces “zëre hapin”. Në përgjithësi, kjo tendencë është parë si një pasojë normale dhe pozitive e shkallës së rritjes, themelimit dhe ristrukturimit. Nga ana e ofertës, institucionet e huaja financiare, që hyjnë në këto tregje me qëllim të fitimit të shpejtë të tregut, shpesh kanë lehtësuar financimin në zgjerimin e shpejtë të kredisë. Risku i rritjes së shpejtë të kredive është nënvlerësuar, për shkak të vështirësive të matjes së parashikimeve të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik dhe lidhjes së tij me humbjet e kredisë. Si rezultat i kësaj, janë ndërmarrë masat e kujdesshme dhe mbikëqyrëse për të frenuar rritjen e kredisë (Hilbers, Robe, Pazarbasioglu, Johnesen, 2005).

Për më tepër, sipërmarrësve individualë apo investitorëve zakonisht iu mungon kapitali i mjaftueshëm për të vazhduar me projektet e tyre. Bankat komerciale ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit, që i bashkojnë kursimtarët dhe investitorët, duke i kanalizuar në mënyrë teorike fondet e investimeve për përdorimet që sjellin normën më të lartë të kthimit, duke e zmadhuar specializimin dhe ndarjen e punës (Todaro, 2003). Modeli neoklasik i rritjes na tregon se një rritje në investimet e efektshme të kursimeve në projekte të reja dhe inovative është një nga gjeneratorët kryesorë të rritjes ekonomike (cituar në Armenta).

Dhënia e kredive është një vlerë më rëndësi, sepse mjetet e mobilizuara mund të shfrytëzohen racionalisht, duke i përdorur në sferën e prodhimit, në shpejtimin e procesit të riprodhimit, të qarkullimit dhe të sektorët e tjerë, të cilët llogariten si sektorë që përshpejtojnë zhvillimin ekonomik. Kreditë janë mjaft të rëndësishme dhe një ndër faktorët kryesorë në stimulimin e zhvillimit ekonomik në rajon, prandaj edhe fokusi në pjesën e parë të këtij punimi do të jetë analiza e rolit të kredive dhe ndikimi i tyre në rritjen ekonomike (Rritja e kredive në GDP), ku interesi kryesor në këtë punim do të jetë Kosova.

1. TEORITË BASHKËKOHORE MBI TRANZICIONIN DHE EFEKTI SAJ NË VENDET NË TRANZICION

Është me vlerë të kujtojmë që Evropa nuk ka qenë e bashkuar dhe aq më pak demokratike. Tranzicioni si akt dhe si veprim ekonomik, politik dhe social pa dyshim që ka për mision edhe përgatitjen e atyre shteteve në minimizimin e faktorëve joekonomikë dhe atyre politik, në mënyrë që faktorët tjerë dhe përgjithësisht ata ekonomik të jenë agjentë vendimtarë në krijimin e mirëqenies së qytetarëve të vetë. Procesi i ndryshimeve të këtyre shteteve komuniste të Evropës Qëndrore dhe Lindore si edhe orientimi i tyre ndaj sistemeve me strukturë demokratike kërkon, një revizionim ciklik të gjyqimeve dhe analizave.

Ndryshimet më të mëdha që nga viti 1989, kanë qenë:

- bashkimi i dy Gjermanive,
- shpërbërja e BS në 15 vende të ndryshme,
- shpërbërja e Jugosllavisë në 7 shtete të reja dhe
- shpërbërja e Çekoslovakisë në dy pjesë, Republikën Çeke dhe Republikën Sllovaqe

Produkte të kësaj periudhe tranzitore, padyshim janë edhe rritja e ksenofobisë, korrupsioni në sferën e privatizimit që po i përcjellë të gjitha vendet me afëra dhe skandale të ndryshme, si edhe ndryshimet thelbësore në sferën e shtresëzimit social që katapultuan një shtresë të re të pasurve në mënyrë jo të merituar. Pra, jo duke hyrë në një konkurrencë lojale me rregulla dhe parime të njohura dhe të verifikuara nga përvoja e vendeve dhe shteteve me një traditë të gjatë demokratike.

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, në periudhën postkomuniste, transformimi, i quajtur gjerësisht tranzicion, drejt demokracisë, do të përfshinte në radhë të parë Gjermaninë, Austrinë, Italinë dhe Finlandën. Procesi i tranzicionit evidentoi si të nevojshme, përshtatjen në varësi të veçorive të secilit vend. Tranzicioni politik në vendet e Evropës Qëndrore- Lindore eci në kalvarin e gjatë të vështirësive që kishin të bënin me vendosjen e sistemit politik shumëpartiak, por edhe të të gjitha pasojave që sillte ky sistem në administrimin e pushtetit dhe të mekanizmave zgjedhorë, që të çonin deri tek pushteti. Ky tranzicion u përshkua nga një rritje e madhe e ndjenjave të nacionalizmit, për shkak se këto shtete u ngritën në bazë të parimit të komb-shtetit.

Në shumicën e rasteve ky tranzicion u krye në kushte qetësie dhe mirëkuptimi në mes etnive, mirëpo shpërbërja e Jugosllavisë, nëpërmjet luftërave të përgjakshme, bëri që në fund të shekullit të shkuar, si rrjedhojë e shkatërrimeve dhe krimeve të kryera, në mes të Evropës të krijohej një histori e dhimbshme. Tranzicioni i tejzgjatur në vendet e Europës Qëndrore e Lindore krijoi efekte të ngjashme për shkak të një të kaluarë të tyre të përbashkët nën regjimin komunist, regjim ky i ngritur fillimisht mbi idealin e një rendi socialist mbarë botëror, por që më pas degjeneroi në një totalitarizëm të pashembullt e mizor.

Komunizmi mbi sundoi rreth gjysmë shekulli në këto vende nëpërmjet supremacisë së partisë shtet, një ekonomie të komanduar, një shoqërie të përçarë nga lufta e klasave dhe mbikëqyrur nga shërbimet sekrete shtetërore.

Do të pritëshin iniciativat e ndërmarra nga Gorbaçovi si Perestrojka e Gllastnosti e sidomos rënia e Murit të Berlinit më 1989, faktorët që do të hapnin dritën jeshile për një të ardhme të re për këto vende. Vendet ish-komuniste i përqaftuan reformat që do t'i çonin në një demokraci pluraliste, në një ekonomi tregu me rregulla të barabarta konkurrence, në një shoqëri civile të lirë e të aftë për vetëvendosje etj, pra u përpoqën të ndjekin udhën e simotrave të tyre perendimore. Por euforia fillestare e vendeve të Europës Qëndrore dhe Lindore kaloi shpejtë dhe këto vende u përballën me një realitet të ri po aq problematik e të turbullt nga shumë pikëpamje.

2. ZHVILLIMI I SEKTORIT FINANCIAR NË VENDET NË TRANZICION

Procesi i tranzicionit që filloi në vitet e 90- ta të shekullit XX, shkaktoi rënien e sistemit socialist në Evropën Qendrore dhe Lindore. Shpërbërja e RFSJ, dhe futja e Kosovës në administrimin e dhunshëm të Serbisë e ka shkatërruar Sistemin ekonomik dhe atë bankar edhe ashtu të pa qëndrueshëm që kishte Kosova në kuadër të ish shtetit Jugosllav. Sistemi bankar në Kosovë gjatë viteve të fundit është transformuar krejtësisht, i drejtuar nga sistemi bankar me pronësi shtetërore në ish Jugosllavi, në një sistem bankar me pronësi private pas çlirimit. Privatizimi i sistemit bankar në Kosovë si pjesë e paketës së masave të ndërmarra nga politika e qeverive në 11 vjetëshin e kaluar, kishte për qëllim të fuqizonte sistemin financiar, të pakësonte mundësinë për kriza të ardhshme dhe të rriste eficientën e ekonomisë.

Në të njëjtën kohë, si rrjedhojë e zhvillimit të saj ekonomik, Kosova po përgatitet të integrohet tërësisht në ekonominë botërore dhe në tregjet financiare ndërkombëtare. Ndër aspektet tjera të reformës që duhet zbatuar është reforma ekonomike, e cila do të përfshinte një ndryshim rrënjësor nga sistemi jo efikas i centralizuar, në një sistem aktualë në kushtet e biznesit të tregut, i cili do të largojë reflektimet negative në të gjitha sferat e jetës ekonomike të cilat në një mënyrë kanë shkaktuar një krizë të madhe ekonomike dhe kolaps ekonomik. Me reformimin e

përgjithshme te sistemit ekonomike, si tendencë me e shfaqur ne fuqizimin e sistemit financiar, është paraqit transformimi i sistemit bankar, i cili ka marrë krejtësisht elemente të reja dhe ka arritur një zhvillim te shpejtë.

Për shkak te shumë mangësive institucionale dhe ndikimit te madh te lobit bankar, bankat tregtare e kanë ndryshuar aktivitetin e tyre burimor, dhe në vend të kryerjes së aktiviteteve të ndërmjetësit financiar midis kursimeve dhe rritjen e kapitalit, ato janë shndërruar në instrument të lobimit të madh bankar në mënyrë që të fitojnë fitime sa ma të mëdha. Funksionimi i mirë i sistemit bankar është një faktor i rëndësishëm për kanalizimin e fondeve në ekonomi në mënyrë efikase dhe përrritjene ndërmjetësit bankar. Nxitja e konkurrencës në sistemin bankar është një tjetër faktor, që ndikon në ofrimin e shërbimeve sa më të mira për klientët, që siguron përdorimin e teknologjisë së re bankare, prezantimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, uljen e kostos të shërbimit bankar etj. Kjo i shërben afrimit të klientëve me bankat.

3. ZHVILLIMI I SEKTORIT FINANCIAR DHE RITJJA EKONOMIKE NË KOSOVË

Sistemi financiar i Kosovës ka vazhduar zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të tij në mënyrë të qëndrueshme. Gjithashtu, asetet e sistemit financiar u rritën në mënyrë të vazhdueshme.

Deri në fund të vitit 2008 totali i aseteve të industrisë bankare arriti vlerën prej 2.3 miliardë euro, ku rritja e aseteve aseteve të industrisë bankare është 70.8 për qind të gjithsej aseteve të sistemit financiar (RV, 2008, RSF, 2014).

Zhvillimi i sektorit te industrisë bankare ishte rreth 80 për qind të gjithsej aseteve të sistemit financiar. Ndërsa, prej vitit 2009-2014, gjithsej asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 4.3 miliardë euro, ku rritja e Sipas RV dhe RSF (2004, 2014), struktura e industrisë bankare vazhdon të dominohet nga bankat me pronësi të huaj, ku nga gjithsej dhjetë banka të licencuara, tetë janë me pronësi të huaj, të cilat në vitin 2005 menaxhonin 66.3 për qind të gjithsej aseteve të industrisë, ndërsa në vitin 2014 menaxhonin 90.5 për qind të gjithsej aseteve të industrisë dhe 92.8 për qind të kapitalit.

Sa i përket numrit të institucioneve financiare që operojnë në Kosovë, struktura e këtij sektori ka mbetur e pandryshuar për shumë vite. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 u licencua edhe një bankë me kapital të huaj, duke e çuar në dhjetë numrin e bankave të licencuara në Kosovë.

Shkalla e koncentrimit të tregut në industrinë bankare ka vazhduar të zvogëlohet edhe gjatë viteve të fundit. Pjesëmarrja e aseteve të tri bankave më të mëdha, në qershor 2014, ka zbritur në 67.2 për qind krahasuar me 67.8 për qind në vitin paraprak. Ndërsa, në vitin 2004 asetet e tri bankave më të mëdha në gjithsej asete ishin në 74.4 për qind. Rënia e shkallës së koncentrimit shprehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), trendi i të cilit tregon për një rënie të vazhdueshme të koncentrimit të aseteve, kredive dhe depozitave. Rënia e shkallës së koncentrimit, ndër të tjera, reflekton rritjen më të shpejtë të aseteve, stokut të kredive dhe nivelit të depozitave në bankat më të vogla krahasuar me bankat më të mëdha.

KONKLUZIONE

Përderisa sistemi financiar është gjenerator i zhvillimit, është insitucioni i vetëm që injekton para në ekonominë e Kosovës dhe që mundëson siguri financiare për njerëzit dhe bizneset sa i përket investimeve dhe operacioneve të përditshme; ristrukturimi i tij është i lidhur më shumë me aftësi udhëheqëse se sa aftësi shkencore. Bazuar në historinë ekonomike të vendeve të ish-Bashkimit Sovjetik siç janë, Polonia, Republika Çeke dhe Hungaria, rregullimi i sistemit financiar është një rrugë e gjatë me shumë rënie dhe ngritje dhe që kërkon përmirësime të përditshme. Nuk është e mjaftueshme të përqëndrohet vetëm në industrinë bankare. Sistemi financiar si tërësi duhet të jetë konkurrues, ku çdo industri në mes vete duhet të kompenzoj njëra tjetrën (lëvizja e fondeve nga një industri në tjetrën) në mënyrë që të mos lejohet ajo që Kosovarët po përjetojnë tani, tepricën e parave në industrinë bankare.

Sistemi financiar siç është tani, duke konsideruar të gjithë faktorët, krijon pasiguri të madhe ekonomike në mesin e Kosovarëve. Njerëzit kanë ide, bizneset kanë plane, por nën kushtet aktuale të sistemit financiar, e veçanërisht industrisë bankare, është e pamundshme të aktivizohen motorët e zhvillimit. Andaj roli i BQK eshte te siguroj nje klime te sistemit bankar qe eshte i pranueshem si per konkurrencen ashtu edhe per qytetaret.

Evidenca tregoi se roli i industrisë bankare, si ndërmjetësues nëpërmjet transferimit të mjeteve nga sektorët të cilët kanë suficit të mjeteve financiare tek sektorët të cilët kanë mungesë të mjeteve financiare, ka ndikuar në rritjen ekonomike në vend. Analiza e regresionit lidhur me ndikimin e kredive totale në zhvillimin ekonomik tregoi se rritja e kredive totale për një përqind ndikon në rritjen ekonomike për 0.1 për qind. Gjithashtu, sa i përket ndikimit të kredive në sektorin privat, 62 për qind e ndryshimeve në normën e rritjes ekonomike shpjegohet nga ndryshimi në normën e rritjes së kredive. Siç edhe pritej, rritja e kredive konsumuese nuk ka efekt në rritjen ekonomike.

LITERATURA

- [1] Shibley, Telhami -“Power and Leadership in International Bargaining: The Path to the Central and Eastern Europe”, NY, 2000, faqe
- [2] Eva Hyskaj Tafili, Tranzicioni politik në Evropën Qëndrore dhe Lindore,Tiranë; Shtëpia botuese e Librit Universitar, 2008 fq.20
- [3] Ballester, L; Ferrer, R; Gonzales, C; Soto, G, M (2009): “Determinants of Interest Rate Exposure of Spanish Banking Industry, Documentos de Trabajo”, Working Paper, Fq. 1-22.
- [4] Raporti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, viti 2010.

